



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

---

Legjislatura III

Kryesia e Kuvendit të Kosovës

P-002

Prishtinë, më 21 janar 2008, në orën 14:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, të mbajtur më 21 janar 2008

**Në mbledhje morën pjesë:** Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit dhe anëtarët e Kryesisë: Sabri Hamiti, Eqrem Kryeziu, Ibrahim Gashi dhe Nexhat Daci, kurse mungoi (me arsye) Xhavit Haliti.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Thëllënza Arifi dhe Sherif Konjufca;

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi, Eshref Vishi dhe Ismet Hajrullahu;

Nga Projekti për Mbështetje të Mëtejme Kuvendit: Hugues Courtivron;

Nga NDI-ji: Rinor Beka dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup Krasniqi**, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

**Kryetari** hapi mbledhjen dhe kërkoi nga anëtarët e Kryesisë që të procedohet sipas propozimit të rendit të ditës. Kryesia miratoi propozimin e Kryetarit.

**Kryesia** i zhvilloi punimet me këtë

## **R E N D I T E**

1. Caktimi i seancës plenare për nder të pritjes së Presidentit të Shqipërisë, z. Bamir Topi,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,
3. Propozimi për ndarjen e kryesimit të komisioneve parlamentare-vazhdim,
4. Shqyrtimi i Propozimprogramit hyrës për deputetët e rinj,
5. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin e projekteve për investimet kapitale në Kuvendin e Kosovës, të parapara me Projekt-Buxhetin për vitin 2008.

### **1. Caktimi i seancës plenare për nder të pritjes së Presidentit të Shqipërisë, z Bamir Topi**

**Kryetari** i informoi anëtarët e Kryesisë se Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Bamir Topi, do ta vizitojë Kosovën prej 25 deri më 27 janar 2008. Ai, në kuadër të kësaj vizite, ka shprehur dëshirën që me një fjalë rasti t'u drejtohet edhe deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Kryetari propozoi që seanca solemne për nder të pritjes së Presidentit të Republikës së Shqipërisë, z. Bamir Topi, të mbahet më 25 janar 2008, në orën 11:30, ku, ai me një fjalë rasti do t'u drejtohet deputetëve të Kuvendit.

**Kryesia** njëzëri miratoi propozimin e Kryetarit.

### **2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar**

**Sabri Hamiti** pati vërejtje në transkript, në faqen 15 ku fjalët: “Ndërro tezat “ duhet të jetë: “Mos ndërro tezat “.

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit i 15 janarit 2008 u miratua me vërejtjen e Sabri Hamitit.

### **3. Propozimi për ndarjen e kryesimit të komisioneve parlamentare-vazhdim,**

**Kryetari** njoftoi anëtarët e Kryesisë lidhur me propozimin për ndarjen e kryesimit të komisioneve parlamentare. Kryesia, në mbledhjen e kaluar, kishte kërkuar nga Zyra Ligjore e UNMIK-ut interpretim juridik të Kornizës Kushtetuese lidhur me referencat për ndarjen e komisioneve mbi bazën e përfaqësimit të grupeve parlamentare apo mbi bazën e partive dhe të koalicioneve të përfaqësuara në Kuvend.

**Kryetari** informoi anëtarët e Kryesisë me shkresën e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut nr.DO-022 dt.18.01.2008, në të cilën ishte dhënë interpretimi se mbi cilën bazë kryesohen komisionet parlamentare.

Të gjithë anëtarët e Kryesisë mbështetën interpretimin e Zyrës Ligjore të UNMIK-ut.

**Kryesia**, pas diskutimit të të gjithë anëtarëve të saj, vendosi që Kuvendit t’ia paraqes këtë

### **Propozim – Vendim**

Për përfaqësimin e grupeve parlamentare në kryesimin e komisioneve parlamentare

- I. Grupet parlamentare të Kuvendit të Kosovës përfaqësohen në kryesimin e komisioneve parlamentare, si vijon:
  1. GP i PDK-së, kryeson me tri komisione,
  2. GP i LDK-së, kryeson me tri komisione,
  3. GP i AKR-së, kryeson me dy komisione,
  4. GP i AAK-së, kryeson me dy komisione,
  5. GP i LDD-së, kryeson me një komision,
  6. GP 7+, kryeson me një komision dhe
  7. GP i SLS-së, kryeson me një komision.

Për përfaqësimin e grupeve parlamentare me anëtarë në komisionet parlamentare, Kryesia vendosi t’ia propozojë Kuvendit këtë

### **Propozim – Vendim**

Për përfaqësimin e grupeve parlamentare në komisionet parlamentare

- I. Grupet parlamentare përfaqësohen në çdo komision parlamentar, si vijon:
  1. GP i PDK-së, përfaqësohet me nga tre anëtarë,
  2. GP i LDK-së, përfaqësohet me nga tre anëtarë,
  3. GP i AKR-së, përfaqësohet me nga një anëtar,
  4. GP i AAK-së, përfaqësohet me nga një anëtar,
  5. GP i LDD-së, përfaqësohet me nga një anëtar,
  6. GP 7+ përfaqësohet me nga një anëtar, dhe
  7. GP i SLS-së përfaqësohet me nga një anëtar,

**Kryesia**, duke u mbështetur në rregullat 42.4 dhe 48.6 të Rregullores së Punës së Kuvendit, vendosi që më 28 janar 2008 të mbajë mbledhje të përbashkët me kryetarët e grupeve parlamentare për t’i caktuar kryesuesit, zëvendëskryesuesit dhe anëtarët e komisioneve parlamentare.

#### **4. Shqyrtimi i Propozim-Programit hyrës për deputetët e rinj,**

Kryetari i informoi anëtarët e Kryesisë me shkresën e Iniciativës për Mbështetjen e Kuvendit ( me partnerët OSBE, NDI, dhe USAID-in), me të cilën parashihej të organizohej një trajnim për deputetët e rinj të Kuvendit. Gjithashtu, ishte kërkuar nga Kuvendit që t'i përballojnë shpenzimet financiare, që përfshijnë: vendin e mbajtjes së takimeve, drekat dhe pijet, ndërsa për shpenzime e tjera organizative dhe për trajnimin do të kujdeset OSBE-ja.

Kryesia, pasi diskutoi për kërkesën e cekur më lart, mori këtë

#### **Vendim**

Lejohen mjetet financiare për përballimin e shpenzimeve nga buxheti i Kuvendit të Kosovës për Programin hyrës për trajnimin e deputetëve të rinj, që nënkupton: shpenzimet për vendin - sallën e mbajtjes së trajnimit, ushqimin për një shujtë ditore dhe pijet për 66 deputetë.

#### **5. Shqyrtimi i propozimit për ndryshimin e projekteve kapitale të Kuvendit të Kosovës të parapara me Projekt -Buxhetin e vitit 2008**

Kryesia e shtyu për mbledhjen e radhës propozimin për ndryshimin e projekteve kapitale të Kuvendit të Kosovës të parapara me Projekt -Buxhetin e vitit 2008

#### **6. Të ndryshme:**

5.1 Kërkesa e AAK-së për t'ia mundësuar përfaqësuesit të saj të jetë anëtar i Kryesisë së Kuvendit

**Kryesia**, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, nxori këtë

#### **P e r f u n d i m**

Kryesia e Kuvendit nuk është organ kompetent për të marrë nisma për ndryshimin dhe plotësimin e Kornizës Kushtetuese.

5.2 **Eqrem Kryeziu** shtroi kërkesën që makina e Kuvendit, e destinuar për udhëtimin e tij, të qëndrojë në Prizren, për të mos bërë udhëtime të dyfishta.

**Kryetari** e deklaroi mbledhjen të mbyllur në orën 15:10

Kryetari i Kuvendit të Kosovës  
**Jakup KRASNIQI**

---

E hartoi:

**Divizioni i Çështjeve Plenare e Procedurale**